



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

NJ O F T I M Datë  
7 janar 2019

Në bazë të nenit 179/8 të Kushtetutës, të nenit 7 të ligjit “Për Organizimin dhe Funksonimin e Institucioneve për të Luftuar Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar” (këtej e tutje Ligji për SPAK) dhe të nenit 48/2 dhe 3 të Ligjit “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (këtej e tutje Ligji për Statusin),

Këshilli i Lartë i Prokurorisë shpall sot fillimin e procedurave për plotësimin e 15 (pesëmbëdhjetë) pozicioneve vakante në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (këtej e tutje Prokuroria e Posaçme).

Këshilli i Lartë i Prokurorisë iu bën thirrje që të të kandidojnë të gjithë prokurorëve që plotësojnë kushtet e mëposhtëme:

- Kanë ushtruar funksionin si prokuror për jo më pak se 10 vjet;<sup>1</sup>
- Nuk kanë masa disiplinore në fuqi;<sup>2</sup>
- Japin pëlqimin për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake<sup>3</sup>;
- Sigurojnë pëlqimin e anëtarëve të afërt të familjes për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake;<sup>4</sup> - Nuk janë anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë<sup>5</sup>.

Në bazë të nenit 6/1/a të Ligjit për SPAK, pas dorëzimit të aplikimeve, kandidatët do t’i nënshtrohen verifikimit të pasurisë dhe të figurës<sup>6</sup>;

---

<sup>1</sup> Sipas nenit 47/2/c të ligjit për Statusin.

<sup>2</sup> Sipas nenit 48/8 të ligjit për Statusin.

<sup>3</sup> Sipas nenit 6/1/b të ligjit për SPAK.

<sup>4</sup> Sipas nenit 6/1/c të ligjit për SPAK.

<sup>5</sup> Sipas nenit 149/10 të Kushtetutës.

<sup>6</sup> Kandidatët që e kanë kaluar me sukses vetting-un përpara datës së dorëzimit të aplikimeve, konsiderohen se e plotësojnë këtë kusht. Aplikimet e kandidatëve që nuk e kanë kaluar ende vetting-un i përcillen menjëherë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për kryerjen e verifikimeve të parashikuara nga ligji i vetting (shih nenin 57/11 të ligjit të SPAK).

Në rast se numri i kandidatëve që plotësojnë kushtet ligjore është më i madh se numri i vendeve vakante, Këshilli do të shqyrtojë kandidimet dhe do të vlerësojë / rendisë kandidatët përkundrejt kritereve të mëposhtëme:

- Rezultatet e kandidatëve në 2 vlerësimet e fundit të performancës;
- Përvoja e kandidatëve në pozicionet e komanduara;
- Përvoja e kandidatëve në hetimin e krimit ekonomik dhe krimit të organizuar (pranë Njësive të Përbashkëta Hetimore / NJPH, Prokurorisë së Krimeve të Rënda dhe Drejtorisë kundër Korrupsionit dhe Krimit Ekonomik në Prokurorinë e Përgjithshme / PP);
- Kohëzgjatja e shërbimit në NJPH, Prokurorinë e Krimeve të Rënda dhe ose Drejtorinë kundër Korrupsionit dhe Krimit Ekonomik në PP.
- Vjetërsia si prokuror;
- Vjetërsia si jurist;

Sipas nenit 48/14 të Ligjit për Statusin, Këshilli i Lartë i Prokurorisë do të miratojë rregulla më të detajuara për vlerësimin dhe renditjen e kandidatëve për prokurorë të SPAK. Këto rregulla do të bëhen publike përpara fillimit të procesit të shqyrtimit të aplikimeve.

Kandidatët që plotësojnë kushtet e sipërpërmendura i paraqesin kërkesat e tyre jo më vonë se 30 ditë kalendrike nga data e shpalljes së thirrjes në faqen e internetit të Këshillit.

Krahas kërkesës për kandidim, kandidatët dorëzojnë pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Një letër motivimi (jo më shumë se 3 faqe A4) ku tregojnë sukseset e tyre më të spikatura në hetimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe arsyet e kandidimit;
2. Kopje e noterizuar e diplomës së studimeve në drejtësi dhe e listës së notave;
3. Kopje e noterizuar e diplomës së studimeve në Shkollën e Magjistraturës dhe e listës së notave (nqs ka);
4. Kopje e Dekretit të Presidentit për emërimin si Prokuror;
5. Kopje e Urdhërit të Prokurorit të Përgjithshëm për caktimin si prokuror në Njësinë e Përbashkët Hetimore, Prokurorinë e Krimeve të Rënda ose Drejtorinë kundër Korrupsionit dhe Krimit Ekonomik në Prokurorinë e Përgjithshme;
6. Kopje të 2 akteve të fundit të vlerësimit të punës dhe aftësive profesionale e morale si prokuror (nqs ka);
7. Vërtetim nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore në Prokurorinë e Përgjithshme që tregon se kandidati nuk ka masë disiplinore në fuqi.
8. Formularët e parashikuar në shtojcat B1 dhe B3 të ligjit 95/2016 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Institucioneve për të Luftuar Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar” të plotësuar rregullisht;

9. Kopje të Vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit apo Kolegjit të Apelit nëse kandidati për prokuror në Prokurorinë e Posacme ka kaluar me sukses procesin e rivlerësimit;

Aplikimet do të dorëzohen në formë elektronike në adresën: [vendevakante@klp.al](mailto:vendevakante@klp.al) (në këtë rast të gjitha dokumentat e sipërpërmendura duhet të jenë të skanuara) ose në formë fizike në adresën: Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Bulevardi “Zogu I”, Ish Godina e KLD, Kati VI.<sup>7</sup>

S U K S E S E

---

<sup>7</sup> Për dosjet e dorëzuara fizikisht KLP do të lëshojë një vërtetim që tregon marrjen në dorëzim të aplikimit dhe të gjitha dokumentave shoqëruese.